



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

### **Nr. 33**

Datë: 06. 12. 2023. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Mufera Shinik, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ Nr.31 dhe 32/2023**
- 3. Aktivitetet e Zyrës**
  - Rekomandimi për regjistrim të partisë politike “Srpska Demokratija”
- 4. Raportet e Këshillave të KQZ**

#### **3.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore**

1. Njoftim lidhur me numrin e kërkesave për ndërrimin e Qendrës të Votimit;
2. Njoftim për ndryshimin e lokacionit të Qendrës së Votimit në Besi;
3. Njoftim me rekomandimet nga raportet, analizat dhe publikimet e KQZ-se 2023;

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Historikut të Zgjedhjeve;
5. Njoftim me vlerësimin paraprak të zbatimit të planit të punës së KQZ për vitin 2023 - periudha Janar - Nëntor 2023;
6. Njoftim për draft Planin e Punës së KQZ 2024;

## 5. Këshilli për Personel

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për organizimin e punëtorisë për Rregulloret e brendshme të KQZ

## 5. Të ndryshme!

---

### 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

**Kreshnik Radoniqi**: Me fillimin e mbledhjes, kryetari Radoniqi paraqiti agjendur e ngjeshur të mbledhjes.

**Arianit Elshani**, tha se pika e 5 te jete prezantim paraqitje nga kryeshefi, po ashtu edhe pika per draftplanin e punës për vitin 2024. Pra, te jene si aktivitete te sekretariatit. Po ashtu, edhe historiku i zgjedhjeve te hiqet nga rendi per shkak te dizajnit, edhe pse mund te paraqitet përmbajtja...

**Me vota unanime u miratua rendi i ditës.**

Në vazhdim u miratuan proceverbale nga mbledhjet e KQZ Nr.31 dhe 32/2023. Proceverbali 32, me një votë abstenim nga Sami Kurteshi për shkak se nuk ka qenë prezentë në këtë mbledhje.

### 3. Aktivitetet e Zyrës

Rekomandimi për regjistrim të partisë politike “Srpska Demokratija”:

**Besnik Buzhala**, drejtor i ZRCKFSP tha se zyra më 7 nëntor 2023 ka pranuar një aplikacion për regjistrim si parti politike të iniciativës “Srpska Demokratija”. E kemi pranuar dokumentacionin, e kemi shqyrtuar statutin, listën e nënshkrimit, si dhe kjo iniciativë ka paguar edhe taksen për regjistrim. Dokumentacioni sipas ligjit dhe rregullave të zyrës, ka qenë në rregull. Dosja e këtij subjekti, është publikuar në edhe në ueb faqen tonë për shqyrtim publik. Prandaj, ne rekomandojmë për regjistrim. Kjo, nëse miratohet rekomandimi ynë, do të jetë partia politike e regjistër me nr. 50.

Pa debat, me vota unanime u regjistrua ky subjekt politik.

#### **4. Aktivitetet e Sekretariatit**

##### **Njoftim me vlerësimin paraprak të zbatimit të planit të punës së KQZ për vitin 2023 - periudha Janar - Nëntor 2023:**

Burim Ahmetaj, tha se sekretariati ka përgatitur vlerësimin paraprak të planit të punës së KQZ-së që do ti shërbej hartimit të planit të punës së KQZ për vitin 2024. Ky është raport dhe përfshinë periudhën janar-nëntor. Janë dy dokumente: dokument narrativ, dhe dokumenti në ixel që pasyron secilin aktivitet. Kemi realizuar 48% të planit të punës, si dhe një pjesë prej 10% e planit, do të realizohet në periudhën në vijin.

Në vazhdim z. Ahmetaj, shpjegoi edhe pjesët e tjera të planit që, janë në proces por që janë të lidhura me aktivitete digjitale, të informimit të votuesve etj. Pra, janë 12 aktivitete ose 20% e planit, dhe aktivitetet e tjera...

Sekretariati, ka përgatitur edhe planin e punës, dhe janë dokumentet që do ti shqyrtojmë edhe në punëtorinë që do ta mbajmë. Pra, e gjithë kjo punë, do ti shërbej hartimit të planit të punës për vitin 2024.

Alban Krasniqi, tha se raporti përmban të dhëna sasiore- statistika. Raporti ka dy probrobleme: e para, ndoshta këtu kemi të bëjmë më shumë me mënyren si është planifikuar plani i aktivitetve, por që vitin që vjen të përfshihen punët dhe detyrat e përditëshme të sekretariatit. Edhe këto, duhet të përfshihen, pra aktivitetet sipas departamenteve. Krijohet përshtytja sikur janë vetëm nja 30 aktivitete, por ka edhe punë si zëvendësimet, dhe e dyta, me problematikat që shfaqen në rrjedhën e aktiviteteve të përditshem, realizimi, rekomandimet sepse kjo ndihmon edhe në hartimin e planit të ardhshëm...

#### **5. Njoftim**

Në vazhdim, **z. Ahmetaj** e informoi KQZ-në lidhur me atë se Agjencia e Statistikave të Kosovës më 29 nëntor, ka kërkuar nga KQZ rreth 700 kuti që do ti përdorë për regjistrim të popullsisë, regjistrim të ekonomive familjare dhe banesave. Ne, edhe jemi takuar me zyrtarë të ASK-së. Pra, ata kërkojnë përkrahje. Pra, fjala është për huazim ose dhënie në shfrytëzim...

Na duhet një “memorandum” lidhur me dhënien e kutive, sado që kjo nuk bie ndesh me bashkëpunimin ndërinstytucional.

Anëtarët e KQZ-së, autorizuan me vota unanime kryetarin e KQZ-së z. Kreshnik Radoniqi për bashkëpunim të mëtejshëm – nënshkrimin e memorandumit me ASK-në.

## **6. Raportet e Këshillave të KQZ**

### **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

#### **1. Njoftim lidhur me numrin e kërkesave për ndërrimin e Qendrës të Votimit:**

**Arianit Elshani**, kryesues i KOZ-it, I njoftoi anëtarët e KQZ-së me numrin e kërkesave për ndërrimin e Qendrës të Votimit në fushatën që është ndërmarrë për ndërrimin e QV-e. KOZ është njoftuar me procesin e këtij aktiviteti që bëhet për herë të parë në procesve jo zgjedhore. Deri më më 30 nëntor s aka zgjatur fushata e informimit të votuesve, janë pranuar 1987 kërkesa. Nga këto, 1693 kërkesa janë aprovuar, 94 për shkak të mungesës së dokumentacionit janë refuzuar.

Në këtë pikë, diskutoi Burim Ahmetaj që foli rreth Suftverit që ende nuk është bash i gatshëm, dhe që të integrohet në “E-Kosova”. Fokusi këtu, por ende jemi në fazën e opsioneve, kërkesave etj. Moduli i vjetër, është me probleme dhe, nuk është imun ndaj sulmeve eventuale...

**Fazli Stollaj**, tha se fushata ka qenë e sukseshme por duhen edhe disa lëvizje, mes sistemit të vjetër dhe të riut...

Diskutuan: Arianit Elshani, Sami Kurteshi, Burim Ahmetaj, Burim Ahmetaj, Kreshnik Spahiu, drejtor i IT-së, Alban Krasniqi. Diskutimet kishin të bënin kryesisht lidhur me përdorimin e suftverit, mes inkorporimit të sistemit të vjetër dhe atij të riut, moduli, rreziqet, siguria etj.

#### **2.Njoftim për ndryshimin e lokacionit të Qendrës së Votimit në Besi:**

**Arianit Elshani**, tha se sekretariati ka marrë një kërkesë që për shkak të ndërtimit të një shkolle në fshatin Vranidoll, ku banorët e këtij fshati kanë votuar në dy zgjedhjet e fundit kanë votuar në Besi. Ata na njoftojn se 984 votues të barten në qendren e tyre, ku ata tradicionalisht kanë votuar.

### **3. Njoftim me rekomandimet nga raportet, analizat dhe publikimet e KQZ-se 2023:**

**Arianit Elshani**, tha se sekretariati e ka përgatitë këtë raport para mbajtjes së punëtorisë dhe se janë njoftuar zyra e BE dhe OSBE që ti kenë edhe ata rekomandimet e tyre, sigurisht do ti kemi në punëtori.

### **4.Shqyrtimi dhe miratimi i Historikut të Zgjedhjeve:**

**Arianit Elshani**: E kemi një raport përmbajtësorë lidhur me këtë dokument të cilin KQZ e ka për herë të parë, dhe se përfshinë një historik voluminoz. Këtu, përfshihen zgjedhje që nga vitit 1992, procesin zgjedhor para shpalljes së pavarësisë, dhe zgjedhjet e mëpastajme...

Është një dokument me elemente kryesore që e pasqyron një proces një historik të vërtetë të procesit zgjedhor. Forma dhe dizajni, do të shihen në ndërkohë...

**Ilir Gashi** tha se, mendoj që proceset zgjedhore për mendimin tim, do duhej të ishte një dokument që do të përfshinte tranzicionit, dhe sidomos pas vitit 2008. Këtu, më shumë është dhënë rëndësi një periudhe që ne s'kemi qenë dhe, mendoj se nuk përputhet me rrjedhën historike. Mendoj që kjo ishte dashur të bëhet që kur ne, jemi të pavarur. Unë, nuk mendoj që e miratoj sepse, kam vërejtjet e mia...

**Sami Kurteshi**, tha se analizat, dokumentet duhet të publikohet. Duhet ti publikojmë. Kam disa vërejtje, dhe mendoj se në një, është personalizimi, spese mungon së paku një fjalë e kryesuesit, ka edhe tjera...Por, mendoj që ta lëmë për mbjedhjen tjetër dhe ta shohim më me kujdes...

**Sami Hamiti**, tha se është dokument me interes. Periudhat, kohët mund të diskutohen. Një historik i OSBE-së ka ekzistuar. Kërkesë e jonë ka qenë me dhanë një historik që prej viteve të 90...Ta shohim më mirë...? Po...!

**Alban Krasniqi**, tha se duhet të shihet, jo konteksti por, praktika e zgjedhjeve...

**Ibrahim Selmanaj**: Unë, qysh atëherë kam pasur rezervat e mia, dhe ju e dini qëndrimin tim prandaj, ndoshta duhet shty miratimin, sepse janë disa procese që duhet ti shohim, pra ende ta analizojmë sepse, ka nevojë. Në parim, se kam kundërshtuar por I kam pasur rezervat e mia.

### **5.Njoftim**

**Kreshnik Radoniqi**, e njoftoi KQZ-në lidhur me një takim me përfaqësues I korporates "Meta". Tema ishte e bashkëpunimit mes kësaj korporate dhe KQZ-së lidhur me proceset zgjedhore. Ata, po ofrojnë

pa ndonjë kompensim material mbajtjen e “në facebook” të rrjedhës së procesit përgjatë procesit zgjedhor.

**Sami Kurteshi**, e kundërshtoi këtë ofertë të kësaj korporate. **Arianit Elshani**, tha se Kreshnik Spahiu mund të na njoftoj...

## **6. Këshilli për Personel**

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për organizimin e punëtorisë për Rregulloret e brendshme të KQZ:

...**Alban Krasniqi** tha se, u shfaq shqetësimi, ne duhet ta nxjerrim një “vendim” sepse duhet të shtyhet data. Pra, të mbahet më 18, 19, 20 (punëtorja në Kosovë).

**Kreshnik Radoniqi**: A jeni të pajtimit ? Po, domethënë shtyhet për këto data...

Miratohet...

**Kreshnik Radoniqi**: Kush vjen me mua në Tiranë... ?

Unë, Ilir Gashi dhe Ibrahim Selmanaj. A jeni për...? Në rregull, miratohet, falemnderit...

Kam edhe dicka: ka mbetur te rregulloret zgjedhore te, rregulla për “votim jashtë vendit”. A kemi marrë përgjigje nga MPJ...?

**Alban Krasniqi**: Rregullorja gati është e kryer, por mbeten aspektet praktike: mso të veprimet ad – hok...Janë çështje krejt praktike...

**Arianit Elshani**: Edhe rregullar zgjedhore të fillojmë ti miratojmë një nga një, most e mbetem i peng...